



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:091360

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06312482

C.nr.1698/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil gjyqtari Shyqri Hoxha, me zyrtaren ligjore Sh.M. në çështje juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditësit B. S. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Prisig" me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit prej 5.000.00 euro, jashtë seancës gjyqësore më datë 17 tetor 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

REFUZOHET kërkesëpadia paditësit B.S. nga Prizreni me të cilën ka kërkuar që të "**OBLIGOHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "Prisig", me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit material dhe jo material për lëndimet e pësura në aksidentin e datës 28.12.2022, paditësit B.S. të ia kompensoi shumën prej 5.000.00 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë, së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, si dhe të obligohet e paditura në pagimin e shpenzimeve të procedurës" **NË TËRESI SI E PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Paditësi B.S. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av.B.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 21.03.2024, ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Prisig" me seli në Prishtinë, për çështjen juridike me objekt kontesti kompensim dëmi, me vlerë të kontestit prej 5.000.00 euro.

I autorizuari i paditësit Av. B.M. me parashtresën e datës 15.10.2024, e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje juridike kontestuese me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, dhe në mungesë të interesit juridik ka paraqitur tërheqjen kërkesëpadisë, duke i kërkuar nga gjykata që të bie aktgjykim në bazë të heqjes dorë

nga kërkesëpadia, pasi që paditësi nuk ka kërkesa tjera lidhur me këtë çështje kontestimore.

Gjykata ne kuptim te dispozitave nga neni 149 te Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1698/24, me datë 17 tetor 2024

Gjyqtari
Shyqri Hoxha

KESHILLE JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, ne afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit ne Prishtinë.